



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**V E N D I M**

**Nr. 18, datë 17.06.2025**

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË ZONJËS  
NURIHAN META (SEITI) NË VENDIN VAKANT, PËR GJYQATAR NË  
GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA GJYKATA E LARTË E  
SHQIPËRISË MË DATË 11.12.2024**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

|                       |                           |
|-----------------------|---------------------------|
| <b>Sokol Sadushi</b>  | <b>Kryetar</b>            |
| <b>Marjana Semini</b> | <b>Zëvendëskryetare</b>   |
| <b>Ilir Toska</b>     | <b>Anëtar</b>             |
| <b>Alma Muça</b>      | <b>Anëtare</b>            |
| <b>Elvana Çiçolli</b> | <b>Anëtarzëvendësuese</b> |
| <b>Besart Kaçkini</b> | <b>Anëtarzëvendësues</b>  |
| <b>Irma Balli</b>     | <b>Anëtare</b>            |
| <b>Genti Xholi</b>    | <b>Anëtarzëvendësues</b>  |
| <b>Enkela Vlora</b>   | <b>Anëtare raportore</b>  |

Asistuar nga sekretare Rovenë Behaj, në mungesë të Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), në mbledhjen e datës 17.06.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR GJYQATAR**

**NË GJYKATËN KUSHTETUESE:                      Znj. Nurihan Meta (Seiti)**

**OBJEKTI:**

**Përfundimin e procedurës së kandidatës  
zonjës Nurihan Meta (Seiti) për vendin  
vakant për gjyqtar në Gjykatën  
Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e  
Lartë në datën 11.12.2024.**

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Pasi dëgjoi relatin e anëtares së Këshillit, gjyqtarës Enkela Vlora (Bajo), lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

#### Informacion i përgjithshëm mbi kandidaturën dhe caktimin e relatorit

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 11.12.2024, Gjykata e Lartë ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj.

2. Në përfundim të afatit të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Gjykata e Lartë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën përfshihej dhe kandidatja Nurihan Meta (Seiti), së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Në datë 15.01.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), realizoi procedurën e shortit për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjodh anëtarja Enkela Vlora, ndërsa këshilltare ligjore Aulona Bodo.

### II. Informacion mbi ecurinë e procedurës së verifikimit të kandidaturës

4. Znj. **Nurihan Meta (Seiti)**, si një nga kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED, i ndryshuar, është njoftuar me shkrim në datë 17.01.2025, për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim datë 17.01.2025, është kryer nëpërmjet rrugës elektronike, në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, i cili gjendet i administruar në dosjen e kandidatit.

5. Në datën 21.01.2025, kandidatja **Nurihan Meta (Seiti)** është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ka tërhequr formularët e deklaratave, autorizimeve dhe informacioneve të përcaktuara sipas ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED, i ndryshuar.

6. Në datën 21.01.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, nëpërmjet formës elektronike të njoftimit (i cili është i administruar në dosje), ka njoftuar kandidates **Nurihan Meta (Seiti)** në lidhje me: *“...Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurave për verifikimin e kandidimit tuaj, lidhur me Deklarimin e Pasurisë, ju sjell në vëmendje në cilësinë e kandidatit të kësaj vakance, që plotësimi i formularit duhet të bëhet në zbatim të seksionit A. Verifikimi i pasurisë së kandidatit, pika 61 e Vendimit nr. 4 të KED, datë 11.03.2019 " Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë" i ndryshuar. Në zbatim të kësaj pike, formulari duhet plotësuar në format e detyruara (elektronike dhe shkresore ), në të kundërt parashikohen pasojat sipas pikës 78: ndalimi i kandidimit. Kërkohet nga Ju konfirmimi i menjëhershëm i marrjes në dijeni të këtij njoftimi, po në rrugë elektronike, në të njëjtën adresë elektronike sikurse rezulton më sipër....”*.

7. Rezulton se kandidatja **Nurihan Meta (Seiti)** në datën 24.01.2025, ka paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi autorizimet dhe deklaratimet përkatëse të nënshkruara nga vetë ajo apo edhe personat e lidhur me të sipas ligjit. Gjithashtu, kandidatja ka vendosur në dispozicion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, edhe: (i) Formularin e Vetëdeklarimit *“Për Pozicionet Drejtuese të Mbajtura në Parti Politike nga Kandidati për anëtar të Gjykatës Kushtetuese gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit për vitin 2021”*; (ii) Formular për vetëdeklarim sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrohen funksione publike”*; (iii) Formulari i aplikimit *“Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”*, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29 të ligjit 452015. (i njëzuar me origjinalin nga noteri publik). Ky fakt provohet nga përmbajtja e proces-verbalit me nr. 46 Prot., datë 24.01.2025, i nënshkruar nga punonjësi i KED dhe vetë kandidatja, si dhe i administruar në dosjen gjyqësore.

### **III. Ecuria e procedurës pranë ILDKPKI, lidhur me kriterin e verifikimit pasuror**

8. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si pikës 60 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 të KED *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, nëpërmjet shkresës me nr. 64 Prot., datë 29.01.2025, i i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

9. Me shkresën e datës 766/1 Prot., datë **17.02.2025**, ILDKPI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se: *“...Nga verifikimi i listës së kandidatëve që kanë paraqitur interes për plotësimin e vendimit vakant në Gjykatën Kushtetuese, ju bëjmë me dije se: ...Kanë dorëzuar brenda datës 14.02.2025 në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003..., i ndryshuar si dhe Udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 927, datë 01.11.2021..., Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë..., kandidatët: ... Nurihan Meta...”*.

10. Me shkresën nr. 766/6 Prot., datë 25.04.2025, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Interesave Private ka përcjellë Aktin e Përfundimit të Kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit për pozicione të sistemit të drejtësisë, znj. **Nurihan Meta (Seiti)**, për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese”, me nr. 3/23 Prot., datë 25.04.2025, në të cilin ka arritur këto rezultate: “...Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, Ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 115/2016, datë 3.11.2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe Vendimin nr. 4, datë 11.3.2019 të KED, konstatohet se për kandidatin Nurihan Meta;

- a) **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.**
- b) **ka mosdeklarime dhe burime të pjesshme financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;**
- c) **nuk ka kryer fshehje të pasurisë;**
- d) **nuk ka kryer deklarim të rremë;**
- e) **nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave....”.**

11. Në datën 02.05.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nëpërmjet rrugës elektronike i ka njoftuar kandidates **Nurihan Meta (Seiti)**, Aktin e Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë me nr. 3/23, datë 25.04.2025 të përcjellë nga ILDKPKI, duke i bërë me dije se: “...ILDKPKI, me shkresën nr. 766/6 Prot, date 25.04.2025 ka dërguar pranë KED, Aktin e Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë me nr. 3/23, datë 25.04.2025, për kandidaturën tuaj. ILDKPKI, lidhur me periudhën e verifikuar ka ardhur në përfundimin se:

- Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,
- Ka mosdeklarime dhe burime të pjesshme financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- Nuk ka kryer fshehje të pasurisë,
- Nuk ka kryer deklarim të rremë,
- Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Në zbatim të nenit 229 pika 2 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 26, 66, 67 dhe 68 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, po ju vihet në dispozicion akti i kontrollit i hartuar nga ILDKPKI (në formë të skanuar) me qëllim që të njiheni me të, si dhe të jepni shpjegime apo komentet tuaja në lidhje me këtë raport kontrolli. Referuar dispozitave të cituara më sipër, keni të drejtë që, brenda një afati 5 ditor nga ky njoftim të paraqisni shpjegime me shkrime në lidhje me konkluzionet e arritura dhe eventualisht dokumente mbështetës drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë. Nëse vlerësoni se keni të nevojshme të

*konsultoheni me Aktin e Kontrollit të ILDKPKI edhe në forme origjinale, mund të paraqiteni në kohën më të shpejtë të mundshme pranë zyrave të Këshillit, gjithsesi bashkëlidhur gjendet dhe kopja e skanuar. Lutemi të konfirmoni marrjen dijeni të këtij njoftimi në të njëjtën adresë elektronike të këtij komunikimi... ”.*

#### **IV. Ecuria e procedurës për tërheqjen nga kandidimi.**

12. Në datën 02.05.2025, kandidatja Nurihan Meta (Seiti), i ka kthyer përgjigje Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në rrugë elektronike, duke i bërë me dije se: *“...Kërkoj të ndërpritet marrja në shqyrtim e aplikimit tim, duke hequr dore nga gara e shpallur nga Gjykata e Lartë për vendin vakant të znj. Holta Zaçe.... ”.*

13. Po në rrugë elektronike, në datë 02.05.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka komunikuar kandidates Nurihan Meta (Seiti) njoftimin, duke i bërë me dije se: *“...Për shkak të procedurës dhe formalizimit të kërimit tuaj për të hequr dorë nga gara e shpallur për vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë, kërkojmë që kërkesa juaj të formalizohet me shkrim, kur të pasqyrohet qartësisht vullneti nëpërmjet nënshkrimit të saj, të cilën mund ta dorëzoni pranë Zyrës së Këshillit, nëpërmjet shërbimit postar apo edhe nëpërmjet rrugës elektronike... ”.*

14. Në datën 02.05.2025, kandidatja Nurihan Meta (Seiti), i ka kthyer përgjigje Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në rrugë elektronike, duke i bërë me dije se: *“...Faleminderit! Po kjo mënyrë të shprehuri më duket se plotëson kushtet e kërkesës suaj për rrugë elektronike. Për momentin jam larg koordinatës suaj Institucionale... nuk kam mundësi me shkrim.... ”.*

#### **V. Qëndrimi i relatorit në lidhje me tërheqjen e kandidatit nga gara.**

15. Tërheqja nga kandidimi është një e drejtë që i njihet kandidatit në pikën 8 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për Procedurën e Verifikimit të Kandidatëve për Pozicionet Vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, të KED-së, i ndryshuar, e cila parashikon shprehimisht: *“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në fagen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.*

16. Ndërsa, në pikën 31 të të njëjtit vendim, parashikohen veprimet e relatorit që pasojnë njoftimin e tërheqjes nga kandidimi dhe konkretisht: *“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit”.*

#### **VI. Njoftimet dhe paraqitja e relacionit për Mbledhjen e KED**

17. Sa më sipër, në datën 28.05.2025 është përgatitur ky relacion që përshkruan procedurën e zhvilluar, në lidhje me ecurinë e procedurës së kandidimit të kandidatës Nurihan Meta (Seiti) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024. Këto akte i paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje mbledhjes së KED-së.

18. Gjithashtu, pas komunikimit me kryetarin e KED-së dhe caktimit të mbledhjes për në datë 17.06.2025 ora 14.00, kandidatës Nurihan Meta (Seiti) i njoftohet në rrugë elektronike koha e zhvillimit të mbledhjes, duke i dërguar edhe kopje e këtij relacioni. Njoftimi i tij kryhet në zbatim të pikës 34 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, duke administruar një kopje të njoftimit në dosjen e kandidatit.

19. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materialet të çështjes, i dërgohen edhe Avokatit të Popullit. Kopje e këtij njoftimi administrohet gjithashtu në dosjen e kandidatit.

20. Koha e zhvillimit të mbledhjes, rendi i ditës dhe relacioni i përgatitur për kandidaten Nurihan Meta (Seiti) i njoftohen edhe subjekteve, të cilët sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e KED-së. Edhe kopjet e këtyre njoftimeve administrohen në dosjen e kandidatit.

21. Gjithashtu, dita dhe ora e zhvillimit të mbledhjes së KED-së, si dhe rendi i ditës publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

## **VII. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

### **1. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve kushtetuese dhe ligjore të kandidimit**

22. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në interpretim dhe zbatim të dispozitave ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatës Nurihan Meta (Seiti) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 11.12.2024.

23. Në pikën 1 të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë: “1. .... shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Kryetari i Gjykatës së Lartë pranon kandidaturat brenda 30 ditëve nga njoftimi, i bën ato publike dhe ia dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi...”.

24. Në zbatim të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 234 e vijues të ligjit nr. 115/2016, pas dërgimit të listës së kandidatëve që kanë shprehur interes së bashku me dokumentacionin e paraqitur, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30.09.2024, KED ka filluar në datën 15.01.2025 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

25. Ligji nr. 8577/2000 dhe ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e mosparaqitjes apo të tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të KED-së në raste të tilla. Nga ana tjetër, ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se : *“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”.*

26. Mbi bazën e këtij autorizimi ligjor, KED ka nxjerrë vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar. Në pikat në pikat 8 dhe 31 të këtij vendimi parashikohet se:

*“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.*

.....

*“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit”.*

27. KED, në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore, të zbatueshme në rastin e mosparaqitjes dhe tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidates Nurihan Meta (Seiti). Kandidatja është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, sipas rrugës elektronike në datë 17.01.2025. Në vijim në datë 21.01.2025, kandidatja Nurihan Meta (Seiti), u paraqit pranë KED-së dhe tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimeve e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi, midis të cilave edhe ato për deklarimin e pasurisë dhe interesave financiarë.

28. Në datën 02.05.2025, kandidatja Nurihan Meta (Seiti), i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në rrugë elektronike kërkesën, duke i bërë me dije se: *“...Kërkoj të ndërpritet marrja në shqyrtim e aplikimit tim, duke hequr dore nga gara e shpallur nga Gjykata e Lartë për vendin vakant të znj. Holta Zaçe....”.* Në vijim të kërkesës së Këshillit për ta formalizuar këtë kërkim në një kërkesë më objekt dhe parashtrime te qarta, kandidatja Nurihan Meta Seiti me e-malin e datës 02.05.2025, kandidatja Nurihan Meta (Seiti), i ka rikonfirmuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në rrugë elektronike, se: *“...kjo mënyrë të shprehuri më duket se plotëson kushtet e kërkesës suaj për rrugë*

*elektronike. Për momentin jam larg koordinatës suaj Institucionale... nuk kam mundësi me shkrim.... ”.*

29. KED vlerëson të rregullt procedurën e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe në aspektin e qartësisë së vullnetit të shprehur prej kandidatës Nurihan Meta (Seiti) për tërheqjen nga kandidimi.

30. KED vlerëson që shprehja e interesit dhe kandidimi për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

31. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedimit, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet në Gjykatën Kushtetuese, atëherë nuk ka më vend të vijnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

32. Në këto rrethana, duke u bazuar në aktet që përmban dosja e kandidimit të analizuar më sipër në këtë vendim dhe në mbështetje të pikës 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikave 8, 28, 31, 78 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset përfundimi i procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit të kandidatës Nurihan Meta (Seiti) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datë 11.12.2024.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/c të ligjit nr. 8577/2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, si edhe pikave 30, 51, 52, 61, 62 dhe 78 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019, *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

#### **VENDOSI:**

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatës Nurihan Meta (Seiti), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 11.12.2024.



2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Nurihan Meta (Seiti).
3. Kandidatja Nurihan Meta (Seiti) ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**ANËTAR**

**Zv/KRYETARE**

**KRYETAR**

**Ilir Toska**

**Marjana Semini**

**Sokol Sadushi**

**ANËTARE**

**ANËTARE ZËVENDËSUESE**

**ANËTARE**

**Alma Muça**

**Elvana Çiçolli**

**Enkela Vlora**

**ANËTARE**

**ANËTAR ZËVENDËSUES**

**ANËTAR ZËVENDËSUES**

**Irma Balli**

**Genti Xholi**

**Bezart Kaçkini**